



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2022:241923  
Datë: 30.04.2024  
Numri i dokumentit: 05639808  
C.A.P. nr. 684/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, nga gjyqtari individual Besnik Bislimaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.A., me seli në Prishtinë Rr. “N. T.” nr. ...., kundër debitorit H. B., me vendbanim në Skenderaj Rr. “T. M.”, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 3,056.32 euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, Departamenti i përgjithshëm, E.nr. 494/2008 i datës 24.04.2023, me datë 30.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë si e pas afatshme, ankesa e të debitorit H. B., me vendbanim në Skenderaj Rr. “T. M.”, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, Departamenti i përgjithshëm, E.nr. 494/2008 i datës 24.04.2023.

A r s y e t i m

Gjykatës e shkallë së parë, me aktgjykimin e ankimuar E.nr. 494/2008 i datës 24.04.2023, I. APROVOHET PJESËRISHT prapësimi i debitorit H. B., me vendbanim në Skenderaj Rr. “T. M.”. II. SHFUQIZOHET PJESËRISHT Urdhri për lejimin e Përmbarimit E.nr.494/08 i datës 19.12.2008, për periudhën kohore prej datës 12.05.2005 deri me datën 31.12.2006 në shumë prej 2,171 euro si borxh i parashkruar dhe OBLIGOHET debitori H. B., me vendbanim në Skenderaj Rr. “T. M.”, që kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.A. me seli në Prishtinë, në emër të borxhit për konsumin e energjisë elektrike t’ia paguajë shumën prej 885.32 euro (tetëqind e tetëdhjetë e pesë euro e tridhjetë e dy cent), për periudhën kohore prej datës 01.01.2007 deri me datën 31.08.2008, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, duke filluar nga pranimi i këtij vendimi e deri në pagesën definitive, si dhe në emër të taksës gjyqësore t’i paguaj kreditorit shumën prej 20 euro.

Kundër këtij aktvendimi, pas skadimit të afatit të paraparë ligjor, ankesë ka ushtruar debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikim i te drejtës materiali, me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovojë si të bazuar dhe ta prishë aktvendimin dhe lëndën ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë në ri vendosje apo të njëjtin ta ndryshoj dhe të refuzohet në tërësi si i pa bazuar propozimi për përmbarrim i kreditorit.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit në këtë procedurë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe në kuptim të nenit 194, 195, par.1, pika (a), në lidhje me nenin 186 par.1 dhe 2 të LPK-se, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pas afatshme.

Gjykata e Apelit, duke vlerësuar fillimisht lejueshmërinë dhe afatshmërinë e ankesës së ushtruar, nga debitori H. B. nga Skenderaj, konstatoi se e njëjta është ushtruar pas skadimit të afatit të paraparë ligjor prej 7 ditësh. Nga shkresat e lëndës, konstatohet në këtë çështje përmbarrimore, debitori aktvendimin e ankimuar e ka pranuar me datë 05.05.2023 e që vërtetohet nga fletë kthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa ankesa në Gjykatën Themelore në Prishtinë, është ushtruar me datë 15.05.2023, përmes postës me Rekomand R ....5, e që në gjykatën e shkallës së parë është pranuar me datë 17.05.2023, fakte të cilat vërtetohet nga vula e pranimit e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit vlerëson se nga momenti i pranimit të aktvendimit nga ana e debitorit, kur ka filluar të rrjedhë afati kohorë për paraqitjen e ankesës dhe deri më datën e parashtrimit të ankesës të dorëzuar në gjykatë, me datë 15.05.2023, kanë kaluar më tepër se 7 ditë, që nënkuptohet se ankesa është ushtruar pas kalimit të afatit të përcaktuar me ligj, ngase si datë e fundit e debitorit për paraqitjen e ankesës ka qenë data 12.05.2023 (e Premte).

Me neni 77 par. 2 të LPP-së, i cili parasheh që “Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit..”. andaj, në rastin konkret debitori, ankesën e tij e ka parashtruar pas afatit ligjorë, dhe meqenëse hedhjen poshtë të ankesës si të pas afatshme nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë, në kuptim të nenit 186 paragrafi 1 dhe 2, të LPK-së, sipas të cilit ankesa është e pas afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj, atëherë gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 195, par.1, pika (a), ku përcaktohet që gjykata e ankimit ta hedhë poshtë ankesën si të vonuar, jo të plotë apo të palejueshme, si dhe nenin 196, të LPK-së, ku është përcaktuar se: ankesën e vonuar, jo të plotë, apo të palejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se këtë nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë, siç është parashikuar në nenin 186 par.1 dhe 2 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2022:241923  
Datë: 30.04.2024  
Numri i dokumentit: 05639808

Andaj, nga të cekurat si më lartë, Gjykata e shkallës së dytë në kuptim të nenit 208 dhe 209, pika (a) të LPK-se, lidhur me nenit 17 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË  
C.A.P.nr. 684/2023 me datë 30.04.2024

Gjyqtari  
Besnik Bisliraj, d.v